

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Spanja nis hetim penal për hyrjen e mbi 70 mijë emigrantëve në Ceuta - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/spanja-nis-hetim-penal-per-hyrjen-e-mbi-70-mije-emigranteve-ne-ceuta
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:10:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 18:18:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e0ba46a0e7482ad0cf5acccd2cd8fccf9b4a5b13f73be7c3c30161acbb7d9f90
TEKSTI	0b8da5035a620945a0414d514e7684186d1ba4ac0d0daf8dc62ab400998cd413
PAMJA	bffe1bdfd2fa8d897e217701ebe60f5836ebd6bd770299b0a322d2432265cbe27

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eb1f9cdf2d9784ae4ed6a876e8d86366c8575eecaa5eccc0c4fe788f873101b2
E MËPARSHMJA	e01047514255e6ff524c3665e2fbaf59c605901f3183023f9fbc933cc39a0500
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/eb1f9cdf2d9784ae4ed6a876e8d86366c8575eecaa5eccc0c4fe788f873101b2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Klos/ Ujin e kemi dhuruar nga Perendia, nuk lejojmë ta grabisë Qeveria! Banorët e fshatit turistik kundër hidrocentraleve



Bota

Spanja nis hetim penal për hyrjen e mbi 70 mijë emigrantëve në Ceuta

Qeveria spanjolle ka deklaruar se nuk ka "prova përfundimtare" që tregojnë se Maroku ishte përgjegjës për hyrjen masive të emigrantëve në fund të korrikut. Më shumë se 70 mijë emigrantë kaluan nga Maroku në Ceuta gjatë kësaj periudhe.



Emigrantë në Ceuta



Redaksia

7 Shtator, 20:14 | Përditësimi: 7 Shtator, 20:18

f Share Tweet



A A

Gjykata Kombëtare e Spanjës ka urdhëruar nisjen e një hetimi penal për hyrjen e dhjetëra mijëra emigrantëve në enklavën spanjolle të Ceutës në muajin korrik. Gjyqtarja hetuese María Tardón tha se ekzistojnë arsye për të besuar se "sjellje kriminale të kryera jashtë vendit kanë dëmtuar rëndë integritetin territorial të Spanjës", duke përdorur hyrjen masive në territorin spanjoll si mënyrë për ta bërë këtë.

Gjykata vendosi se ka juridiksion për të hetuar dyshimet për krime kundër integritetit territorial, vrasje nga pakujdesia dhe pjesëmarrje në organizatë kriminale, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Prokuroria Publike.

Sipas gjyqtarës Tardón, fluksi i emigrantëve përbën një nga metodat karakteristike të "luftës hibride" ose të ashtuquajturës "zonë gri", me synimin për të ndikuar në jetën dhe të drejtat e qytetarëve spanjollë në [Ceuta](#).



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

Transportonte 7 emigrantë të paligjshëm drejt Tiranës, arrestohet 32-vjeçari në Korçë! Në kërkim bashkëpunëtori që i iku policisë

Raporti i policisë spanjolle, i cili flet për "lejueshmëri totale" nga forcat marokene të sigurisë, ishte një nga bazat kryesore për hapjen e hetimit. Tardón tha se nga Maroku kishte ardhur një "lehtësim i qartë dhe i padiskutueshëm i procesit", veçanërisht përmes sjelljes së forcave marokene të sigurisë, e cila, sipas saj, është dokumentuar dhe filmuar.

Sipas vendimit, torcat marokene te sigurise, "nuk bene asnje perpjekje" per te ndaluar hyrjen masive te emigrantëve. Disa prej tyre, sipas gjyqtares, madje u dhanë emigrantëve "udhëzime aktive" se si të kryenin kalimin.

Qeveria spanjolle ka deklaruar se nuk ka "prova përfundimtare" që tregojnë se Maroku ishte përgjegjës për hyrjen masive të emigrantëve në fund të korrikut. Më shumë se 70 mijë **emigrantë kaluan nga Maroku** në Ceuta gjatë kësaj periudhe.

Autoritetet marokene nuk kanë komentuar raportin e policisë spanjolle. Megjithatë, mediat marokene e kanë cilësuar atë si një dokument të "dështuar", duke argumentuar se nuk përmban prova konkrete që mbështesin akuzat. Shumica e emigrantëve që hynë në Ceuta janë kthyer tashmë në **Marok**, por mijëra prej tyre kanë mbetur në enklavën spanjolle, ndërsa tensionet politike vazhdojnë të rriten.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: [spanje](#) [marok](#) [emigrante te paligjshem](#) [ceuta](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Spanjë/ Skena kaotike në rrugët e Ceutas, mijëra emigrantë përplasen me policinë në përpjekje për të siguruar një vend në kampin e ri

18 Shtator, 18:08



Me 200 km/orë për të dërguar 50 mln € drogë, si u zbulua banda shqiptare në Spanjë! Sekuestrohet 2.7 kg kokainë

18 Shtator, 08:36



U kap duke transportuar 6 emigrantë sudanez drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Devoll

16 Shtator, 09:35



Antonelli mbret edhe në Madrid, shkëputet në garën për pilot në Formula 1

13 Shtator, 17:11



Mesdheu po bëhet qendra e energjisë së gjelbër në Europë, 682 miliardë euro investime në projekte diellore dhe me erë

11 Shtator, 17:23



Artisti shqiptaro-amerikan Mirud triumfon në 'Premios Juventud' me albumin 'Desnudo'

7 Shtator, 20:35



Kush është grupi i ekstremit të djathtë 'Patriot Platform' që fshihet pas protestave anti-emigrantë në Angli

7 Shtator, 15:51



Britani, protestuesit bllokojnë rrugët për të ndaluar autobusët me emigrantë, përplasje me policinë në qytetin portual të Portsmouth-it (VIDEO)



'Hajde të ikim o burrë', 'skifterët' shqiptarë hyjnë në shtëpinë e influenceres spanjolle: E kuptova nga dritarja e hapur (VIDEO)

6 Shtator, 14:24

7 Shtator, 15:44



BE kopjon 'Gjadrin'/ Pesë vende europiane synojnë qendra deportimi jashtë BE-së, transferimet nga 2027

5 Shtator, 17:08



11 vende të BE-së kërkojnë që t'i jepet fund vetos për vendimarrjet në politikën e jashtme

1 Shtator, 14:23



Kriza e emigrantëve në Ceuta, Sanchez akuza Ruisë dhe Izraelit: Dezinformuan qëllimisht, shkak qëndrimi ynë për luftërat në Ukrainë e Gaza

31 Gusht, 16:51

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.